



Nr. 91/8 Prot
Nr. 0004-22 Dosje

Tiranë më 22.02 2022

**URDHËR
"PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit

Adresa: Tiranë

Per dijëni: Debitorit : Shoqëria "LOSHI BL" sh.p.k Nipt J67902618M Cel: 0674276428

Adresa: Lagjia Nr.1, Banesë Private Nr.509, Rruga Nacionale Elbasan, Qukës, Elbasan

Kreditor : Shoqëria "BAHITI-G" sh.p.k Nipt K83410201O Tel: 0682099329

Adresa: Lagjia Holta, Rruga "10-Korriku", Pranë Hotel Tomorri, Gramsh, Elbasan

Kreditor : Shoqëria Përmbarimore "Kodra Bailiff Service" sh.p.k Nipt L32221069N Tel: 0692121466

Adresa: Rruga "Frederik Shiroka", Kulla 3, Shkalla 3, Apartamenti 4, Njësia Bashkiake Nr.7

Pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "BESA" sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër 0004-22 regj dhe me palë:

Kreditor : Shoqëria "BAHITI-G" sh.p.k Nipt K83410201O

Shoqëria Përmbarimore "Kodra Bailiff Service" sh.p.k Nipt L32221069N

Debitorit : Shoqëria "LOSHI BL" sh.p.k Nipt J67902618M

Objekti : Ekzekutim vendimi

KONSTATOVA:

Për titullin ekzekutiv "Vendimi Nr.10-2021-928 (304), datë 18.05.2021 i Gjykatës së Apelit Durrës", i cili është ndrequr nga Vendimi "Nr.10-2021-2252, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës", i cili përbën njëkohësisht Urdhër Ekzekutim, me palë kreditore Shoqëria Përmbarimore "Kodra Bailiff Service" sh.p.k dhe Shoqëria "BAHITI-G" sh.p.k dhe palë debitore Shoqëria "LOSHI BL" sh.p.k.

Me vendim të përmbaruesit gjyqësor privat, mbështetur dhe në nenin 519 të K.Pr.Civile është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, rrjedhimisht për ekzekutimin e tij, duhet te kryhet verifikimi dhe vendosja masës së sekuestros në QKB, mbi aktivin që zotëron pala debitore.

Për këtë arsye në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile dhe Ligjit Nr.26/2019, datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aksionet, kuotat e debitorit:

- **Shoqëria "LOSHI BL" sh.p.k me Nipt J67902618M**, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimin e këtyre aksioneve/kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qëndrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë.

2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e vijues të K. Pr. Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor të vendit të ekzekutimit brenda 5 ditëve nga marrja dijëni.

Zyra e Përmbarimit Privat "BESA" sh.p.k
PËRMBARUESI GJYQËSOR
Klodiana TABAJ

